

Unë mësoj të flasë ... nga TI!

Këshilla për ju si familje

- Edhe vetëm 15 min në ditë lexim e ndihmojnë mjaftueshëm fëmijun tuaj.
- Kur dikund jeni duke pritur shfrytëzoni kohën për lexim me fëmijun, -një libër i vogël mund të bahet në çdo çantë.
- Mundësoni fëmijut tuaj libra të ndryshëm-llojlojshëm.
- Shfrytëzoni bibliotekat dhe ato që ofrojnë ato.
 - Libra vizatimor (Pappbilderbuch) me kopertinë dhe faqe të trash, janë shumë të përshtatshëm për fëmijë të vegjël.
 - Librat që ndjehen (Fühl- und Mitmachbücher) me prekje dhe janë drejtpërdrejtë aktiv, aktivizojnë menjehershëm disa shqisa të fëmijut.
 - Librat me vizatime pa tekst (Wimmelbücher) me vizatime që tregojnë një tregim dhe motivojnë fëmijun të zbulojë dhe të flasë për të njejtat.
 - Libra me gjësende dhe fjalë (Sachbücher und Lexika) e bëjnë fëmijun kureshtar dhe zgjerojnë njohurinë e fëmijut
 - Libra me tregime në formë poezie ndihmojnë fëmijun tuaj të jetë i vëmendshëm dhe të bashkëbisedojë.
- Mos u habitni nëse fëmijë juaj pas një kohe të gjatë dëshiron ta lexojë edhe njëherë të njejtin libër, ju duhet të gëzoheni sepse nga ky libër fëmijë juaj mëson më së shumti.

Nuk keni kohë për lexim?

- Audio librat, App si „Tiptoi“, dhe mediumet tjera mund të jenë plotësim ose alternativë e mirë për lexim
- Ndoshta njihni ndonjë person i cili do ti lexonte fëmijut tuaj me kënaqësi (fqinjë, miqë, farefis)

Nuk keni libra afër veti në gjuhën amtare?

- Atëherë tregoni ose trilloni përralla, është një zëvendësim i mirë.
- Përdorni libra me vizatime të dendura (Wimmelbücher) pa tekst që të mund të diskutoni për ato.

FËMIU IM DHE GJUHA/GJUHËT E TIJ

Edukimi gjuhësorë në familje

3. Si e zbulon fëmijë përmes lojës kënaqësinë në gjuhë dhe shkrim?

Fletushka të përkthyer në gjuhë tjera të kësaj serie si dhe burimet i gjeni këtu:



Linku i rekomanduar:



Kindergarten

Botuesi:
Deutsche Bildungsdirektion
Landesdirektion deutschsprachiger Kindergarten

*Me përkrahje të Referatit të Qendrës për Migracion dhe Gjuhë si dhe shkencëtarës gjuhësore
Dr. Christiane Hofbauer*

Amba-Alagi-Straße 10
39100 Bozen
T 0471 41 76 50
ld.kindergarten@provinz.bz.it

Si e zbulon fëmijë përmes lojës kënaqësinë në gjuhë dhe shkrim?

3

Librat janë NJËRI ndër çelsat e komunikimit, edukimit dhe dijes

FËMIU IM DHE GJUHA/GJUHËT E TIJ

Edukimi gjuhësorë në familje



ALBANISCH
SHQIP

AUTONOME PROVINZ
BOZEN - SÜDTIROL



PROVINCIA AUTONOMA
DI BOLZANO - ALTO ADIGE



T'i lexoni fëmiut

Librat përmbajnë një gjuhë të pasur që na ofrojnë fjalë dhe forma të fjalive. Përmes së cilës fëmijë zgjeron aftësitë gjuhësore.

Leximi forcon ...

... lidhjen emocionale me fëmijun

Leximi është një mundësi që fëmijut ti kushtohet kohë dhe të fillohet një marrëdhënie e mirë me të. Me këtë fëmijë përjeton ngrohtësinë, afërsinë, përkushtimin dhe përkujdesjen tuaj. Leximi mundëson momente qetësie dhe relaksimi. Tregimet i japin fëmijut hapësirë fantazisë dhe kreativitetit si dhe e forcojnë atë emocionalisht. Figurat në tregim i mundësojnë atij të ndjejë më thellë dhe ti kuptojë ndjenjat e veta më mirë si dhe ti shpreh ato, të identifikohet me figurën dhe që përjetimet e tij nga jeta e përditshme të mund të përpunojë më mirë. Ofron gëzim e kënaqësi.

... zhvillimi gjuhësor dhe kognitiv (njohës) i fëmijut

Leximi rrit kënaqësinë dhe interesimin për kulturën e shkrim-leximit dhe tregimit të përrallave. Gjatë leximit fëmijë njohet me fjalë dhe struktura të reja (të cilat rrallë përdoren në përditshmërinë tonë). Leximi dhe ndëgjimi i tregimeve thellon më tej fjalorin dhe gramatikën. Librat i mundësojnë fëmijut të futen në botën e shenjave, simboleve dhe shkrimeve. Kështu që fëmijë arrin të kuptojë që një fjalë e lexuar ose e shkruar janë një dhe mund të zbërdhehen nga njerëzit tjerë. Ky është themeli i mësimi të shkrim-leximit. Librat të bëjnë kurrështar, japin përgjigje dhe zgjerojnë dijen e fëmijut. Shiqimi dhe leximi i librave ndihmon në kuptimin e realitetit, në koncentrim, mbamendje dhe qëndrueshmërinë për të mësuar më tutje.

Leximi: Kështu ja dalim!

Gjeni kohën, gjeni një vend të rehatshëm dhe krijoni një atmosferë të këndshme. Zgjidhni librat që juve dhe fëmijut tuaj ju pëlqejnë – gëzimi do të shpërthejë dhe leximi do të jetë më i suksesshëm.

I jepni leximit gjallëri:

- Eksperimentoni me zërin tuaj, flisni psh. si ariu, me zë të trashë dhe ngadalë.
- Përdorni mimikën dhe gesticulimin.
- Shiqoni dhe bisedoni me fëmijun tuaj për fotografitë.
- Ndërlidhuni në bisedë dhe në pyetjet e fëmijut tuaj.
- Lejoni fëmijut tuaj që edhe ai të tregojë tregimin.
- Motivoni fëmijun tuaj që ai të mendojë më tutje duke i bërë pyetje:
 - Çka mendon ti?
 - Si mund të përfundojë tregimi?
 - Si cila figurë do të dëshirojë të bëhesh? Përse?
 - Përse kjo figurë është e gëzuar?
 - ...
- Bëjeni leximin një ritual ose shprehni të çmueshme në familjen tuaj.



T'i lexohet fëmijut në gjuhën amtare nënkupton,

- t'i mësohet fëmijut mirë gjuha e parë me qëllim që ti lehtësohet mësimi i gjuhëve tjera
- që qëndrimi i tij emocional dhe personal ndaj gjuhës së tij të forcohet pozitivisht
- që të përkrahet zhvillimi i identitetit të fëmijut
- të krijohet baza për mësimin e një gjuhe tjetër
- që të mësojë dhe thellojë shkrimin e gjuhës amtare

